



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

RAPORTI I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2026, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1.Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka miratuar 14 (katërmbëdhjetë) akte, nga të cilat 4 (katër) projektligje dhe 2 (dy) projektvendime janë konsultuar dhe janë miratuar gjatë vitit 2026, si dhe 8 (tetë) VKM, të cilat janë përjashtuar nga procesi i konsultimit publik në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Numri total i akteve të konsultuara dhe të miratuara për 6 mujorin e pare, nga MBZHR është 6 (gjashtë) akte, si më poshtë:

1. Projektvendimi “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akua kulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”,
2. Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”,
3. Projektvendimi “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, i konsultuar dhe miratuar në vitin 2026,
4. Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”,

5. Projektligji “Për censin e bujqësisë”,
6. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, i ndryshuar.

Në projektaktet e konsultuara dhe miratuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026, 3 (tre) akte janë parashikuar në PPAP e vitit 2026 dhe 3 (tre) janë jashtë saj.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), rezulton se gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2026, ka patur 4330 vizitorë në këtë platformë. Edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi, pjesëmarrja e publikut në dhënien e komenteve dhe sugjerimeve, është ende e ulët. Nxitja e pjesëmarrjes aktive të publikut përbën një ndër sfidat për t’u adresuar nga institucioni ynë.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 6 (gjashtë) akte, 4 projektligje dhe 2 projektvendime, të konsultuara.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për periudhën Janar – Qershor 2026 janë miratuar 14 (katërmëdhjetë) akte, nga të cilat 2 (dy) projektligje dhe 1 (një) VKM, ka qenë të planifikuar në PPAP e vitit 2026 dhe 11 (njëmbëdhjetë) akte janë miratuar jashtë këtij Programi.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Për periudhën Janar – Qershor 2026, bazuar në pikën 1, neni 1, të ligjit “Për konsultimin Publik”, 6 (gjashtë) akte janë miratuar dhe i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, konkretisht:

- Projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akua kulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, i konsultuar dhe miratuar në vitin 2026.
- Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjisllacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”, i konsultuar në vitin 2025 dhe i miratuar në KM në vitin 2026.

- Projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, i konsultuar dhe miratuar në vitin 2026.
- Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”, i konsultuar në vitin 2023 dhe i miratuar në KM në vitin 2026.
- Projektligji “Për censin e bujqësisë”, i konsultuar në vitin 2025 dhe i miratuar në KM në vitin 2026.
- Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar, i konsultuar në vitin 2025 dhe i miratuar në KM në vitin 2026.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

3 (tre) projektligje të konsultuar dhe miratuar gjatë kësaj periudhe janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave, për të cilin është hartuar raporti i VNR-së.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP e vitit 2026 (në 6 (gjashtë) mujorin e parë) janë parashikuar për miratim 22 projekt-akte (projektligje dhe projektvendime), nga të cilat janë miratuar gjashtë (6) akte, dy (2) projektvendime dhe 4 (katër) projektligje.

Për aktet e miratuara gjatë kësaj periudhe, janë konsultuar 4 (katër) projektligje dhe 2 (VKM) dhe janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik, në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” për 8 (tetë) projektvendime.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Janë konsultuar dhe miratuar 6 (gjashtë) akte , 4 (katër) projektligje dhe 2 (dy) VKM, të miratuara në 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2026.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata aktuale në krahasim me 6 mujorin e parë të vitit 2025 është përmirësuar, pasi numri i projekt akteve të konsultuara me publikun është rritur. Në krahasim

me vitin e kaluar kohëzgjatja në tërësi e konsultimit publik për projekt aktet e konsultuara ka qenë e njëjtë. Përfshirja e aktorëve të interesit është mundësuar nëpërmjet takimeve fizike që në fazën paraprake të hartimit të tyre, përpara publikimit të akteve në RENJK.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

- Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik (RENJK);
- Tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi/teknike,
- Komunikim nëpërmjet postës elektronike.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit/takimeve dhe nëpërmjet postës elektronike. Gjithashtu edhe nga konsultimi publik nëpërmjet regjistrat elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike ka patur komente dhe sugjerime, për aktet e konsultuara.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Për projektligjet të cilat janë konsultuar dhe miratuar në këtë periudhë nuk janë realizuar konsultime paraprake, por publikimi i projekt akteve në RENJK dhe njoftimi i grupeve të interesit për zhvillimin e takimeve/tryezave për dhënien e sugjerimeve/komenteve, ka ndikuar në përmirësimin e draftit fillestar të tij.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Kohëzgjatja e konsultimit për projekt aktet paraqitet më poshtë:

- Projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akua kulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, në RENJKP ishte nga data 15.1.2026 deri më 12.2.2026 (20 ditë pune).
- Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”, në RENJKP ishte nga data 19.8.2025 deri më 16.9.2025 (20 ditë pune).
- Projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, i në RENJKP ishte nga data 8.1.2026 deri më 5.2.2026 (20 ditë pune).
- Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”, në RENJKP ishte nga data 3.1.2023 deri më 5.12.2023 (20 ditë pune).
- Projektligji “Për censin e bujqësisë”, në RENJKP ishte nga data 30.7.2025 deri më 27.8.2025 (20 ditë pune).
- Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar, në RENJKP ishte nga data 6.2.2025 deri më 6.3.2025 (20 ditë pune).

Projekt aktet ka qenë të publikuar në RENJK, sipas afatit që përcakton ligji.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e projekt akteve të konsultuara ka qenë 20 ditë pune.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitet e kaluara, ka patur përmirësime të procesit të konsultimit përmes RENJK, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik është rritur në tërësi. Edhe konsultimi përmes formave të tjera të konsultimit (takime on line /postë elektronike) kanë lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces dhe ka rezultuar më i vlefshëm.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Numri i aktorëve jo-qeveritarë që morën pjesë në hartimin projektakteve janë:

- Për projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, është 0.
- Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”, është 2.
- Projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, është 1.
- Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”, është 5.
- Projektligji “Për censin e bujqësisë”, është 4.
- Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar,” është 1.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës:

- “Për projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”:

Përfaqësues të grupeve të interesit, nga procesi i konsultimit nuk ka patur.

- Për projektligjin “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”:

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).

Përfaqësues të grupeve të interesit

- INCA shpk;
 - Shoqata BIO;
 - BTSH;
 - ERZENI shpk;
 - Shoqata “ADAMA”;
 - Shoqata Industria Përpunimit Qumështit;
 - Shoqata BDQ;
 - Grupi EHW, me përfaqësues, z. Luan Leka.
-
- Për projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së;
- QTTB Vlorë;
- QTTB Fushë – Krujë;
- Subjekti “GRAMA”, Counsalting & Engineering (realizuar studimin);
- Asistencë e projektit FAO.

Përfaqësues të grupeve të interesit

Kantinat prodhuese të verës, (17 kantina)

- Për projektligjin “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”:

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së;

- Ekspertët e International Financial Corporation (WEB/IFC);
- State Secretariat for Economic Affairs (SEECO);
- Ekspertë nga Banka e Shqipërisë;
- Ministria e Financave (MF);
- Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF);
- Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- Shoqata Shqiptare e Bankave;
- Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB).

Përfaqësues të grupeve të interesit

- Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD);
- Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).
- Për projektligjin “Për censin e bujqësisë”:

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

Përfaqësues të grupeve të interesit

- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;
- UN Women.
- Për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar:

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së;
- QTTB Fushë – Krujë.

Përfaqësues të grupeve të interesit

Avokat z. Isuf Shehu “Shehu & Partners Law Firm”.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime te

hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit për projektet e konsultuara dhe miratuara për 6 mujorin e parë, të vitit 2026, kanë marrë pjesë 25 palë të interesuara, nga të cilët 6 prej tyre ofruan komente/sugjerime me qëllim përmirësimin e aktit.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e kontribuuesve në konsultimin publik për projekt aktet e konsultuara dhe miratuar gjatë kësaj periudhe janë: (institucione, ekspertë, organizata ndërkombëtare etj)

Kontribuues me sugjerime, nga procesi i konsultimit, ishin:

1. Grupi EHW, me përfaqësues, z. Luan Leka
2. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD)
3. Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)
4. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;
5. UN Women.
6. Avokat z. Isuf Shehu “Shehu & Partners Law Firm”

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara për 6 mujorin e parë të vitit 2026 është përmirësuar, si në konsultimin e akteve përmes RENJK, pasi interesi i publikut është rritur, por edhe konsultimi përmes formave të tjera si (takime on line /postë elektronike) ka lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve dhe kryerjen e procesit në mënyrë transparente.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

- Për projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akua kulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, janë marrë 0 sugjerime/komente.

- Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”, janë marrë 4 sugjerime/komente.
- Projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, janë marrë 0 sugjerime/komente.
- Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”, janë marrë 20 sugjerime/komente.
- Projektligji “Për censin e bujqësisë”, janë marrë 40 sugjerime/komente.
- Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar, ” janë marrë 2 sugjerime/komente.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 66 komente, 32 prej tyre u pranuan plotësisht, 7 u pranuan pjesërisht dhe 27 u refuzuan.

Arsyet e refuzimit të komenteve paraqitet sipas kategorive më poshtë:

1. 1 koment u refuzua, pasi ai lidhej me ndërhyrje jashtë objektit të projekt aktit,
2. 8 komente u refuzuan, pasi ato gjenin zgjidhje në një projekt akt tjetër ligjor/nënligjor,
3. 5 komente u refuzuan, pasi ato binin ndesh me procedurat/afatet e ndjekura nga institucionet e Bashkimit European në kuadër të Acquis që po transpozohet,
4. 13 komente u refuzuan, pasi çështja ishte e rregulluar qartë në projekt akt ose ndërhyrjet preknin teknikën legjislative të hartimit të projekt aktit.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara është përmirësuar. Përfshirja e aktorëve të interesit në projekt aktet e publikuara për konsultim publik të MBZHR-së vazhdon të jetë njëloj aktive, kryesisht në kuadër të takimeve fizike ose nëpërmjet postës elektronike. Megjithatë, janë dhënë udhëzime për rritjen e angazhimit dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të interesit si dhe pjesëmarrjen e gjerë të tyre në RENJK.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR për 4 (katër) projektligjet e konsultuara dhe të miratuara, është përditësuar/ndryshuar pas procesit të konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Janë hartuar gjashtë (6) raporte individuale konsultimi për projektet e konsultuara dhe miratuara, të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka asnjë akt të konsultuar për të cilin nuk është publikuar raporti i konsultimit.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Vetëvlerësimi institucionit për projekt aktet e konsultuara dhe të miratuara është:

- Për projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”, është 7.
- Projektligji “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjisllacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën Shqipërisë”, është 8.
- Projektvendim “Për përcaktimin e Zonave të Prodhimit të Rrushit për Verë”, është 8.
- Projektligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”, është 8.
- Projektligji “Për censin e bujqësisë”, është 8.
- Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar, " është 7.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do

të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces kryesisht në RENJK. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projekt-akteve që hartohen.

Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.

Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ nga çdo drejtori politike. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projekt-akteve.